



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 1227 Prot.

Kuçovë, më 2 . 4 . 2024

V E N D I M

Nr. 22 , datë 17.03.2024

PËR
MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN
E STREHIMIT “ BANESA SOCIALE ME QIRA”,

Këshilli Bashkiak Kuçovë në mbledhjen e tij të datës __. __.2024, mbeshtetur në pikën 2, të nenit 24, germa “k” e nenit 54 , të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 15 dhe 16 të ligjit 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar me ligjin numër 48/2023 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, si dhe V.K.M – së Nr. 334 datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe me propozimin e Komisionit të Strehimit i ngritur me VKB Nr. 40 datë 30.11.2023, “ Për miratimin e rregullores për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Kuçovë”, është hartuar sistemi i pikëzimit për programin “ Banesa Sociale me Qira”,

V E N D O S I

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për programin “ Banesa Sociale me Qira”, sipas aneksi nr.1 bashkëlidhur, i cili do të përdoret për përzgjedhjen e familjeve përfituese nga ky program.
2. Për zbatimin e këtij vendimi garkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Strehimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Ky vendim u miratua me 20 vota pro, — vota kundër, — vota abstenim.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU



Aneksi nr. 1 – Sistemi i pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social “Banesa Sociale me qira” .

	KRITERET E PIKËZIMIT	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	20
A	Nuk disponon banesë në pronësi	11
B	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore	4
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	3
Ç	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor/ Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.	2
1.2	KUSHTET FAMILJARE	20
A	Familje një prindërore që kanë nën garkim fëmijë ku përfshihen dhe vajzat nëna	6
B	Familjet me më shumë se katër fëmijë	6
C	Familje e re, kur moshë e anëtarit më të madh të cilës në momentin e paraqitjes së kërkesës është më e vogël ose baras me 40 vjeç.	3
Ç	Të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar nga institucionet publike të përkujdesit shoqëror.	5
1.3	KUSHTET SOCIALE	40
A	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	5
B	Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve	1
C	Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant /Azilkerkues	1
Ç	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	1
D	Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) /Punonjës i RENE-s /Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	1
DH	Viktimë e dhunës në familje/ Viktimë e trafikimit/ viktimat e mundshme të trafikimit	12
E	Anëtar i minoritetit Rom /Egjiptian	5

Ë	I mitur në konflikt me ligjin	1
F	Komuniteti LGBTI	2
G	Përbëhen nga familje që kanë në ngarkim persona me aftësitë kufizuar apo persona në pension	11
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	20
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare	10
B	Të ardhura deri 70% - 100% të të ardhurave mesatare	5
C	Të ardhura 100%- 120% të të ardhurave mesatare	5

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK

ALEKSANDËR ZIU

